



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçante



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201401724/5

Tiranë ___/___/2014

Lënda: *Rekomandimin për sigurimin e fondeve të nevojshme për rritjen e buxhetit të Policisë së Shtetit me qëllim pagimin e punonjësve të saj për orët e punës shtesë, shërbimet suplimentare dhe shpërblimet për punë të mirë.*

Drejtuar : Ministrit të Financave
Z. Shkëlqim CANI

Për dijeni : Ministrit të Punëve të Brendshme
Z. Saimir TAHIRI

Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit
Z. Artan DIDI

Tiranë

Të nderuar Zotërinj,

Institucioni i Avokatit të Popullit ka regjistruar me iniciativë konform dispozitave të Ligjit Nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, rastin e bërë publik në media, në "Balkaweb", në datën 06.10.2014. Në artikullin me titull, "***Policët, 2 vjet pa marrë paratë e orëve shtesë të shërbimeve***", trajtohet problemi i shkeljes së të drejtave të punonjësve të Policisë së Shtetit, të cilët nuk janë paguar për orët shtesë dhe shërbimet suplementare. Sipas artikullshkruesit, situata paraqitet e njëjtë në të gjitha organet e policisë në vend dhe shuma totale që qeveria u ka efektiveve të policisë shkon rreth 20 milion lekë të reja. Gjithashtu në këtë artikull trajtohet edhe problemi i mosdhënies së shpërblimeve të premtuara për punë të mirë punonjësve të policisë. Një nga këto raste përmendet ai i Komisarariatit të Policisë Nr. 2 Tiranë për punën e mirë për zbulimin dhe arrestimin e bandës së ushtarakëve në kryeqytet të cilëve iu sekuestruan afro 100 kg tritol.

Për shqyrtimin e këtij rasti, me shkresën e datës 17.10.2014 i kërkuam shpjegime Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Në bazë të kësaj kërkesë, Drejtoria e Standardeve Profesionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit me shkresën Nr. 1448/1 Prot., datë 24.10.2014 ndërmjet të tjerave na informoi se, *problemi i ngritur në media qëndron, por buxheti i planifikuar ka qënë i pamjaftueshëm*. Gjithashtu në këtë shkresë informohemi se, *me qëllim shlyerjen e të gjitha detyrimeve të prapambetura, DPP i ka bërë kërkesë Ministrisë së Financave dhe pritet shumë shpejtë alokimi i burimeve financiare të nevojshme*.

Në përfundim të shqyrtimit të këtij rasti të bërë publik në media dhe nga përgjigjia e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, si dhe nga verifikimet e bëra në disa organe të policisë arritëm në konkluzionin se, mospagimi i punonjësve të policisë për orët e punës shtesë, për shërbimet suplimentare dhe për shpërblimet për punë të mirë përbën shkelje të të drejtave të tyre që burojnë nga marrëdhëniet e punës dhe të garantuara nga Kushtetuta, Ligji Nr. 9749, datë 04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit", respektivisht nenet 87 e 88 të tij të cilat rregullojnë kohën e punës e pushimit dhe pagat e punonjësve të policisë, si dhe Vendimi Nr.511, datë 24.10.2002 të Këshillit të Ministrave, "Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore, të ndryshuar, pika 5, ku parashikohet se:

"Me kërkesë të eprorit të drejtpërdrejtë dhe me miratimin e titullarit të institucionit qendror, nga i cili varet institucioni përkatës, nëpunësit apo punonjësit të administratës publike mund t'i kërkohej të kryejnë orë shtesë.

.....Në rastet kur është e pamundur dhënia e pushimit për orët shtesë në punë, nëpunësi apo punonjësi i administratës, që kryen veprimtari operacionale, ka të drejtë të kompensohet me shtesë mbi pagën normale. Çdo orë shtesë tej orarit zyrtar, në ditë të zakonshme paguhet mbi pagën orare edhe me 25 për qind shtesë të kësaj page, ndërsa orët shtesë gjatë ditëve të pushimit apo ditëve të festave, si dhe çdo orë shtesë e kryer nga ora 22:00-6:00 paguhet mbi pagën orare edhe me 50 për qind shtesë të kësaj page".

Sjellim në vëmendje se në veprimtarinë e Avokatit të Popullit, organet dhe punonjësit e policisë nuk kanë qënë vetëm objekt i punës së tij, por edhe subjekte që gëzojnë të drejtën ligjore t'i drejtohen atij. Ankesat e punonjësve të policisë janë vlerësuar dhe do të vlerësohen me prioritet e përkushtim nga ana jonë. Përmbushja e detyrimeve të shtetit në cilësinë e punëdhënësit për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtës kushtetuese të mbrojtjes shoqërore në punë, të garantuar nga neni 49 i Kushtetutës dhe i të drejtave ligjore të punonjësve të policisë të garantuara nga ligji organik dhe VKM i cituar më sipër do të sjellë pamëdyshje motivimin dhe përkushtimin e tyre në kryerjen e misionit ligjor të Policisë së Shtetit të përcaktuar në nenin 1/2 të ligjit "Për Policinë e Shtetit", atë ... ***të ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike, në përputhje me ligjin dhe duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut.***

Më sipër përshkruam përgjigjen e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dërguar institucionit tonë me shkresën Nr. 1448/1 Prot., datë 24.10.2014 nga e cila rezulton se, *problemi i ngritur në media qëndron, por buxheti i planifikuar ka qënë i pamjaftueshëm*.

Ndodhur në këto rrethana ne gjykojmë se, për deri sa aktet ligjore e nëligjore të rregullojnë marrëdhëniet e punës së punonjësve të Policisë së Shtetit, për pagimin e tyre për orët e punës shtesë, për shërbimet suplimentare dhe për shpërblimet për punë të mirë janë në fuqi, ato duhen zbatuar. Me qëllim që të realizohet kjo e drejtë e punonjësve të policisë është e nevojshme rritja e buxhetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit sepse me buxhetin aktual ajo nuk mund ta realizojë atë.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3, të nenit, 63 të Kushtetutës ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* dhe në nenin 21/b të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit.... paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

REKOMANDOJMË :

Marrjen e masave për sigurimin e fondeve të nevojshme për rritjen e buxhetit të Policisë së Shtetit me qëllim pagimin e punonjësve të policisë për orët e punës shtesë, shërbimet suplimentare dhe shpërblimet për punë të mirë konform akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Për masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi të ktheni përgjigje brenda afatit 30 ditor të përcaktuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI